



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 16.02.2026

Numër Protokolli: 977/2026

A.nr.1949/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi dhe anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1949/2025, të datës 26.11.2026, të parashtruar nga ankuesja V.Z-F, kundër organit të punësimit/Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1949/2025, të datës 26.11.2026, të parashtruar nga ankuesja V.Z-F.

II. Anulohet Marrëveshja e datës 01.09.2025 e lidhur me në mes të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil z. I.P, në pozitën e Auditorit të Brendshëm në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

III. Obligohet Drejtori Ekzekutiv në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, që të ndërmerre të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën II të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, V.Z-F, (në tekstin e mëtejme referuar ankuesja), më datë 26.11.2026 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7578/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Marrëveshjes për Transferimin e Përhershëm të Nëpunësit Civil për Interes të Institucionit, të lidhur me datë 01.09.2025, në mes të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, lidhur me transferim e z. I.P, në pozitën e Auditorit të Brendshëm në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 11.11.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa Këshilli më datë 16.12.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 7578/2025, të parashtruar nga ankuesja më datë 26.11.2026 në Këshill; Shkresën me titull: Verifikimi i preambulës nga Zyra Ligjore, me numër protokolli 7726 të datës 31.10.2025; Vendimin me numër protokolli 7726 të datës 31.10.2025; Kërkesën për qasje në dokumente publike të datës 28.10.2025 dhe përgjigjen e datës 31.10.2025; Marrëveshjen e lidhur mes MBPZHR-së dhe AUV-it; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.12.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 16.12.2025; Akt emërimit me numër protokolli 5947 të datës 16.09.2016; Shkresën me titull: Procedim i titullit të punës: AUV, me numër protokolli 6417 të datës 11.10.2016; Akt emërimit me numër protokolli 6417 të datës 11.10.2016; Vendimin për pushim të lehonisë me numër protokolli 7480 të datës 20.10.2025; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 31.12.2011; E-mailin e datës 20.10.2025 (pushim i lehonisë); E-mailin e datës 15.12.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankueses konstatoi se ankesa **është e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës **Auditor i Brendshëm** në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, fillimisht sipas Akt emërimit me numër protokolli 5947, të datës 16.09.2016, me gradë-koeficient 8, ndërsa, sipas Akt emërimit me numër protokolli 6417 të datës 11.10.2016, pozita përkatëse e ankueses është përcaktuar me gradë-koeficient 15.

Më tej, nga shkresat e lëndës rezulton se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, bazuar në nenin 65 paragrafin 1 dhe 5 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, me datë 01.09.2025, kanë lidhur Marrëveshjen për Transferimin e Përhershëm të Nëpunësit Civil për Interes të Institucionit, përkatësisht transferimin e z. I.P, në pozitën e Auditorit të Brendshëm në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Ankuesja, duke u bazuar në Ligjin Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, me datë 28.10.2025, i është drejtuar me kërkesë për qasje në dokumente publik zyrtarit përkatës në AUV, duke kërkuar qasje në marrëveshjen mes MBPZHR-së për transferimin e Auditorit të Brendshëm z.I.P, bashkë me dokumentet tjera në lidhje me këtë marrëveshje, kërkesën, paraqitjen e nevojës për auditor dhe çdo dokument që lidhet me këtë transferim.

Drejtori Ekzekutiv i AUV-it, përmes pikës I të dispozitivit të Vendimit me numër protokolli 7726 të datës 31.10.2025, ka aprovuar kërkesën e ankuses të datës 28.10.2025, për qasje në dokumente publike, gjegjësisht i ka ofruar qasje të plotë në dokumentin “Marrëveshja për Transferimin e Auditorit të Brendshëm nga MBPZHR në AUV”, e cila marrëveshje rezulton se ankuses i është përcjell me datë 31.10.2025, në formë elektronike nga zyrtarit për informim i organit përkatës të punësimit.

Ankuesja, kundër marrëveshjes së lartë theksuar ka parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimet ankimore se sipas Rregullores Nr.01/2011 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AUV, të datës 27.03.2012, është përcaktuar se ky organ i punësimit në strukturën e vet organizative ka vetëm një (1) pozitë të Auditorit të Brendshëm, të cilën edhe e ushtron e njëjta sipas aktit të emërimit përkatës.

Tutje, ankuesja thekson se për të njëjtën marrëveshje është njoftuar me datë 31.10.2025, ndaj pretendon se marrëveshja në fjalë i cenon të drejtat e saj legjitime që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sipas Akt emërimit me numër protokolli 6417 të datës 11.10.2016. Duke theksuar ndër të tjera se nga data 14.10.2025, është në pushim të lehonisë, ku kohëzgjatja për këtë natyrë pushimi sipas nenit 13 paragrafit 1 të Rregullores Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë, mund të zgjasë deri në një vit, ndaj sipas saj në asnjë rrethanë ligjore organi i punësimit nuk ka mundur të lidhë këtë marrëveshje, sepse e njëjta pretendon se pas përfundimit të pushimit të lehonisë, nuk mund të kthehet në pozitën përkatëse, ndaj sipas ankuses, organi i punësimit, në këtë mënyrë ka cenuar parimin bazë të menaxhimit të zyrtarit publik që lidhet me integritetin e vendit të punës e të drejtat të cilat burojnë sipas aktit për themelimin e marrëdhënies së punës.

Rrjedhimisht, ankuesja duke marrë për bazë Vendimin A.nr.893/2025 të Këshillit, me të cilin ishte anuluar marrëveshja e datës 16.04.2025, e lidhur po ashtu mes MBPZHR-së dhe AUV-it, për transferimin e përkohshëm e të njëjtit zyrtar, dhe mbështetur në nenin 8 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, kërkon aprovimin e ankesës dhe anulimin marrëveshjes në fjalë.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuses i’ u referua dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë:

- **Nenit 1**, i cili përcakton se: *Ky ligj ka për qëllim rregullimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht përcaktimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë pranimin, klasifikimin e pozitave, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me marrëdhënien e punës, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës;*

- **Nenit 8 [Parimet e menaxhimit të zyrtares/it publik] paragrafit 1:** *1. Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mosdiskriminimit.*

- **Nenit 37 [Marrëdhënia e punës në shërbimin civil] paragrafit 1 dhe 2:** 1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj.

- **Nenit 65 [Transferimi i përhershëm për interes të institucionit]:** 1. Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. Për rastet kur nëpunësja/i civil është e nivelit drejtues të ulët, mesëm apo të lartë, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar. 2. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Përgatitja profesionale e nëpunëses/it që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet. 4. Transferimi i nëpunëses/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunëses/it civil. 5. Transferimi i nëpunëses/it civil në një institucion tjetër të shërbimit civil, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunëses/it dhe me marrëveshje në mes të institucioneve. 6. Refuzimi për transferimin e përhershëm mund të bëhet vetëm në këto raste: 6.1. kur gjendja e saj/tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor e pamundëson transferimin; 6.2. nëse vendi ku do të transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunëses/it civil; 6.3. për arsye objektive të dëshmuar që e pamundëson transferimin. 7. Qeveria me akt nënligjor, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike miraton rregullat për zbatimin e këtij neni...]

Rregullores (QRK) nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, dispozitat e së cilës përcaktojnë rregullat dhe procedurat për transferimin e përkohshëm, të përhershëm dhe transferimin në rast të ristrukturimit për nëpunësit civil, përkatësisht:

- **Nenit 11 [Transferimi i përhershëm për interes të institucionit]:** 1. Nëpunësi civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në një vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. 2. Për rastet kur nëpunësi civil është i nivelit të ulët, mesëm apo të lartë drejtues, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar. 3. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër që punëson nëpunës civilë. 4. Transferimi i nëpunësit civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunësit civil. 5. Transferimi i nëpunësit civil në një institucion tjetër që punëson nëpunës civilë, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunësit dhe me marrëveshje në mes të institucioneve. 6. Refuzimi për transferimin e përhershëm mund të bëhet vetëm në këto raste: 6.1. kur gjendja e tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor, e pamundëson transferimin; 6.2. nëse vendi ku do të transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunësit civil; dhe 6.3. për arsye objektive të dëshmuar që e pamundëson transferimin. 7. Arsyet objektive për refuzim të transferimit sipas nënparagrafit 6.3 të paragrafit 6 të këtij neni, vlerësohen rast pas rasti nga drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit dhe dëshmohen me dëshmitë përkatëse nga nëpunësi. 8. Arsyetimi i vendimit të transferimit të

përhershëm në interes të institucionit, përmban vlerësimin se nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet. Ky vlerësim kryhet nga NjMBNj e institucionit ku nëpunësi është i punësuar. 9. Në rastet e transferimit jashtë institucionit, vlerësimi sipas paragrafit 8 të këtij neni bëhet në bashkëpunim mes NjMBNj-ve të dy institucioneve.

Andaj, bazuar në kuadrin ligjor të lartë theksuar dhe konstatimet e dhëna në Vendimin A.nr.893/2025 të datës 04.08.2025 Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe ashtu siç është theksuar më sipër ankuesja rezulton se është e punësuar në pozitën e punës Auditor i Brendshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, fillimisht sipas Akt emërimit me numër protokolli 5947, të datës 16.09.2016, e më tej sipas Akt emërimit me numër protokolli 6417 të datës 11.10.2016, ndërsa, organi i përkatës i punësimit, në këtë rast Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, nuk ka argumentuar me prova materiale të ofruara në përgjigjen në ankesë të datës 16.12.2026 dhe provave tjera të dërguara me datë 30.01.2026, se me akt të brendshëm normativ të rregullimit të strukturës organizative në fuqi ka të përcaktuara dy (2) pozita, sikurse pozitës të cilën ankuesja e mbanë sipas akt emërimit e për të cilën edhe është realizuar edhe transferimi i përhershëm, ndërsa, organi i punësimit ka bashkangjitur vetëm e-mailin zyrtar të datës 15.12.2025, të z. B.H-Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, përmes së cilit i njëjti thekson se transferimi përkatës është realizuar në përputhje me nenin 5, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Rregullores së ARK-së Nr.01/2019 për Themelimin dhe Zbatimin e Funkcionit të Auditimit të Brendshëm në Subjektet e Sektorit Publik, duke theksuar po ashtu se Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AUV, është proceduar për aprovim, në të cilin është planifikuar Njësia e Auditimit të Brendshëm, e përbërë nga tre (3) nëpunës.

Nga rrjedhë se organi përkatës i punësimit ka ende në fuqi Rregulloren Nr. 01/2011 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, apo se ende nuk ka përfunduar procesi i klasifikimit të vendeve të punës në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, siç parashihet me dispozitat e nenit 34 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe atëherë në rrethanat e rastit konkret mund të cenohet parimi i sigurisë juridike, ngase veprimet e organit publik duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektohen pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave në këtë rast nëpunësve në kuadër të institucionit, përkatësisht duhet respektuar parimet bazë ligjore të përcaktuara me nenin 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe parimet e përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të përcaktuara me nenin 4, 5, 6 dhe 8.

Ndërsa, me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes të datës 01.09.2025 për Transferimin e Përhershëm të Nëpunësit Civil për Interes të Institucionit të lidhur në mes të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, lidhur me transferim e z. I.P, në pozitën e Auditorit të Brendshëm në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, rezulton se është vepruar në kundërshtim me parimet bazë ligjore të lartë theksuara, ngase me dispozitat e ligjit material nuk është përcaktuar mundësia që një pozitë e cila ka titullar apo zyrtar të emëruar (*i cili është duke ushtruar detyrat e punës*), të ushtrohet qoftë me zëvendësues, ushtrues detyre apo në pozitën përkatëse të bëhet transferimi i tillë, përjashtimisht rasteve të përcaktuara me ligjin material, sikurse, në rastin e

marrjes së pushimit të lehonisë së ankueses prej dymbëdhjetë (12) muajsh, sipas Vendimit me numër protokolli 7480 të datës 20.10.2025, të Drejtorit Ekzekutiv të AUV-it, mund të bëhej transferim i përkohshëm i nëpunësit civil i cili posedon kualifikimet apo plotëson kërkesat e përgjithshme formale për ushtrimin e pozitës së Auditorit të Brendshëm, mirëpo duke marrë për bazë gjendjen faktike të rregulluar me aktin normativ të brendshëm në fuqi, gjithnjë duhet parasysh respektimin e përcaktimeve ligjore nga neni 13 paragrafi 5 i Rregullores (QRK) - Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik dhe nenit 49 paragrafit 6 të Ligjit 03/L-212 të Punës, ndërsa, me rastin e lidhjes e marrëveshjes për transferimin e përhershëm, Kolegji i Këshillit, konstaton se nuk është plotësuar asnjë parakusht ligjor për transferimin e natyrës së tillë në pozitën përkatëse brenda këtij institucioni.

Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara ligjore, përkatësisht nenit paragrafit 3 të nenit 65 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët, nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, Kolegji i Këshillit, si dhe referuar Vendimit Nr.08/226 e të datës 23.10.2024 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar Katalogu i Vendeve të Punës për Shërbimin Civil, pozita Auditor i Brendshëm rezulton se parashihet me Kod SHC-0042, Klasa Profesional 1, dhe hynë në Grupin e auditimit të brendshëm, ku fusha e kërkuar e arsimit është përcaktuar: Ekonomi (pavarësisht nga specializimi), Juridik, Administratë Publike, Financa Publike, ndërsa, sipas Shtojcës Nr.1/5: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 1, të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, gjegjësisht tek kërkesat e përgjithshme formale, për këtë kategori dhe klasë Arsimimi i kërkuar është përcaktuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për fushën e TIK.

Ndërsa, nga analizimi dhe shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se nëpunësi civil z. I.P i transferuar në mënyrë të përhershme, përmes marrëveshjes në fjalë në pozitën e Auditorit të Brendshëm, sa i përket plotësimit të përgatitjeve profesionale, përkatësisht atij arsimor rezulton se posedon: Diplomën me Nr.8 të lëshuar me datë 30.10.2008, nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti i Shkencave të Aplikuara-Ferizaj, me të cilën dëshmohet se i njëjti me datë 04.04.2008, ka mbaruar studimet themelore universitare në Degën e Makinerisë, Profili: Teknika e Përpunimit të Materialeve Artificiale dhe ka fituar titullin: Bachelor i Inxhinierisë Mekanike; si dhe, Diplomën me Nr.2194 të lëshuar me datë 24.10.2019, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”-Fakulteti Juridik në Prishtinë, përmes së cilës dëshmohet se i njëjti është regjistruar në vitin akademik 2009/2010 në studimet master, të cilat i ka përfunduar me datë 20.09.2019, duke mbrojtur me sukses temën e masterit: Subvencionimi i sektorit të bujqësisë përmes fondeve publike, dhe me këtë rast ka fituar titullin MA.SC. i Juridikut-Financiar.

Si rrjedhojë, organi përkatës i punësimit, bazuar në konstatimet e më sipërme me veprimet e ndërmarra e të kontestuar me ankesën e datës 26.11.2025, rezulton se transferimin e përhershëm të nëpunësit të njëjtë civil në pozitën e Auditorit të Brendshëm përmes marrëveshjes në fjalë të datë 01.09.2025, e ka bërë në kundërshtim edhe me paragrafin 3 të nenit 65 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët, nenin 8 dhe 9 të Rregullores (QRK) nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, sepse sipas këtyre dispozitave të elaboruara si më lartë, përcaktohet se përgatitja profesionale e nëpunësit që transferohet

duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet, ndërsa, në rastin konkret i njëjti rezulton se nuk plotëson kualifikimin arsimor të pozitës Auditor i Brendshëm, sipas Rregullores (QRK) nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, Katalogut Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konkretisht nuk posedon diplomë të studimeve sipas fushave të kërkuara arsimore të Grupit Nr.5 të Auditimit të brendshëm, dhe se për më tepër rezulton se i njëjti nuk plotëson kualifikimet për transfer as me përshkrimin e detyrave të punës të datës 31.12.2011, të pozitës së Auditorit të Brendshëm në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ku tek pika 15-Shkathtësitë e kërkuara, si kriter kualifikimi është përcaktuar Diplomë Universiteti-Fakulteti Ekonomike.

Andaj, bazuar në gjetjet dhe konstatimet e lartë theksuara është vërtetuar mjaftueshëm se Marrëveshja për Transferimin e Përhershëm të Nëpunësit Civil për Interes të Institucionit, e lidhur me datë 01.09.2025, në mes të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, për transferimin e z. I.P. në pozitën e Auditorit të Brendshëm në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, është nxjerrë me shkelje të ligjit material dhe procedural, ashtu që i njëjti akt konsiderohet i paligjshëm në kuptim nenit 52 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe për rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 i Ligjit Nr.05/L-031, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, për aprovimin e ankesës së ankueses, anulimin e aktit kontestues, me detyrimin ligjor që Drejtori Ekzekutiv i organit përkatës të punësimit, në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, të ndërmerre të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1949/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:.

- Ankueses V.Z-F;
- Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (Drejtorit Ekzekutiv dhe Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore);
- Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (Sekretares së Përgjithshme);
- Arkivit të KPMSHCK-së